

Fjalë pëshëndetëse nga Fortlumturia e Tij, † Joani, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë Në konferencën përmbyllëse të fushatës “Paqe dhe harmoni”



Fjalë pëshëndetëse nga Fortlumturia e Tij, † Joani,
Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë

Në konferencën përmbyllëse të fushatës “Paqe dhe harmoni”

Të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore,
Të nderuar drejtues dhe përfaqësues të komuniteteve fetare,
Të nderuar përfaqësues të Bashkimit Evropian, të Hedayah-ut, të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi e veçantë të përshëndes përmbylljen e fushatës “Paqe dhe harmoni”. Sot nuk jemi mbledhur vetëm për të dëgjuar rezultatet e katër produkteve video, por për të shqyrtuar një çështje themelore: si mund të

shndërrohet komunikimi në mjet paqeje dhe jo në armë urrejtjeje.

Shqipëria mbart një kujtesë të rëndë, e cila nuk duhet harruar. Gjatë diktaturës komuniste, klerikë dhe besimtarë të komuniteteve të ndryshme fetare u përndoqën, u burgosën, u torturuan dhe u ekzekutuan. Kishat, xhamitë, teqetë dhe manastiret u mbyllën ose u shkatërruan. Në vitin 1967 u ndalua çdo shprehje publike e besimit dhe u bë përpjekje që nga jeta e popullit të fshihej edhe vetë kujtimi i Perëndisë.

Përse një regjim totalitar u tremb kaq shumë nga besimi? Sepse besimi shpall se njeriu nuk është vetëm materie, një numër apo pronë e një ideologjie. Njeriu ka shpirt, ndërgjegje, dinjitet të patjetërsueshëm dhe një destinacion që kapërcen kufijtë e kësaj jete. Prandaj ndërgjegjja e tij nuk mund t'i dorëzohet pa kushte asnjë pushteti tokësor.

Ne u përkasim traditave fetare me dallime të vërteta dhe të rëndësishme. Dialogu i singertë nuk i fsheh dhe nuk i shuan këto dallime. Por së bashku mund të dëshmojmë se jeta njerëzore është e shenjtë, se urrejtja nuk mund të bekohet dhe se feja nuk duhet të përdoret kurrë si pretekst për dhunë, përçmim apo fanatizëm.

Besimi ka një fuqi të pazëvendësueshme: mpreh ndërgjegjen, formon karakterin dhe e mëson njeriun të marrë përgjegjësi edhe për tjetrin. Shkolla zhvillon dijen dhe inteligjencën. Spitali shëron trupin. Kisha prek thellësinë e qenies njerëzore, atje ku formohen qëllimet dhe shërohen plagët e padukshme. Ndërsa burgu kufizon pasojën e së keqes pasi ajo është kryer; edukimi shpirtëror përpiqet të kultivojë ndërgjegjen përpara se dhuna të lindë.

Prandaj, institucionet arsimore dhe shoqërore duhet ta marrin seriozisht edukimin fetar dhe kontributin e komuniteteve fetare në formimin moral, me respekt të plotë për lirinë e ndërgjegjes. Një shoqëri nuk mbrohet vetëm me ligje dhe masa sigurie. Ajo mbrohet edhe duke formuar njerëz që dinë përse duhet ta respektojnë jetën, lirinë dhe dinjitetin e tjetrit.

Në romanin “Vëllezërit Karamazov”, Dostojevski shkruan: “Nëse do t’ia hiqnit njerëzimit besimin në pavdekësinë e vet, do të shteronte menjëherë jo vetëm dashuria, por edhe çdo forcë e gjallë që mban jetën e botës”. Shpresa e përjetësisë nuk e largon njeriun nga bota. Përkundrazi, i jep arsye që ta dojë më thellë tjetrin, të sakrifikojë dhe të mos e shohë si mjet apo armik.

Jetojmë në epokën e rrjeteve sociale, të cilat premtojnë afërsi, por shpesh prodhojnë vetmi. Të njëjtat mjete që përhapin urrejtje, manipulim dhe ekstremizëm mund të përcjellin edhe të vërtetën, shpresën, respektin dhe paqen. Katër videot e

kësaj fushate dëshmojnë se fjala e përgjegjshme mund ta ndalë gjuhën e urrejtjes dhe se komunikimi mund t'ia rikthejë tjetrit fytyrën dhe dinjitetin.

Paqja dhe harmonia nuk kërkojnë që të bëhemi të gjithë të njëjtë. Kërkojnë që, duke mbetur besnikë ndaj bindjeve tona, të flasim me ndershmëri, të dëgjojmë me respekt dhe të bashkëpunojmë për të mirën e përbashkët.

Uroj që përmbyllja e kësaj fushate të mos jetë fundi i një projekti, por fillimi i një përpjekjeje më të qëndrueshme. Le ta përdorim fjalën për të ndërtuar dhe jo për të plagosur, teknologjinë për të afruar dhe jo për të izoluar, ndërsa besimin për të zgjuar ndërgjegjen, për të mbrojtur jetën dhe për t'i shërbyer paqes.

Tiranë, 10 shtator 2026

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)